

Shoqëria për Menaxhimin e të Arkëtueshmeve të Bankave, sh.a. Davçna ul. 1 , Lubjanë, numri amë: 6339620000 (në vijim “Shitësi”) publikon

**SHPALLJE PUBLIKE PËR MBLEDHJEN E OFERTAVE OBLIGUESE
PËR BLERJEN E TË ARKËTUESHMEVE**

Shitësi, në emër dhe për llogari të tij, publikon shpallje publike për mbledhjen e ofertave obliguese për blerjen e të arkëtueshmeve të Shitësit ndaj ndërmarrjeve kosovare: (në vijim: “Shoqëritë”).

1. Objekti i shitjes

Shitësi shet të arkëtueshmet e veta, bashkë me shtesat dhe të drejtat anësore ndaj Shoqërive, të cilat më 8.3.2022, së bashku me shtesat kanë arritur 14 133 463,43 EUR (në vijim: “Të arkëtueshmet”). Shuma e të arkëtueshmeve në rast të lidhjes së kontratës së shitjes rritet për të gjitha shtesat që nga data 8.3.2022 deri në ditën e pagesës. Me blerjen e të arkëtueshmeve, blerësi hyn në marrëdhënien e tërësishme kontraktore ndaj debitorit dhe personave të tretë, të cilët janë të lidhur me të arkëtueshmet dhe me sigurimet përkatëse.

Të arkëtueshmet shiten së bashku si tërësi.

2. Procesi i mbledhjes së ofertave

Procesi i shitjes së të arkëtueshmeve udhëhiqet nga Shitësi. Në procesin e shitjes së të arkëtueshmeve mund të marrin pjesë personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, të cilët në pajtim me kushtet e cekura, siç shpjegohet në vijim, japin ofertë me shkrim në adresën: Družba za upravljanje terjatev bank, d.d., Davčna ulica 1, 1000 Lubjanë, me shënim: »NE ODPIRAJ - PONUDBA ZA ODKUP TERJATEV (KOSOVO)«.

Në pjesën e pasme të zarfit apo paketimit duhet të jenë të shkruar: emri dhe mbiemri, gjegjësisht firma dhe adresa, gjegjësisht selia e ofertuesit. Afati për dorëzimin e ofertave obliguese është deri më 13.4.2022, deri në orën 14:00. Oferta merret konsiderohet e vlefshme në aspektin kohor, nëse arrin te Shitësi brenda ditës së caktuar, deri në orën 14:00.

2.1. Përmbajtja e ofertës obliguese

Në procesin e shitjes, Shitësi do të marrë parasysh ofertat obliguese të dorëzuara brenda periudhës kohore të vlefshme, të nënshkruara nga përfaqësuesi ligjor i ofertuesit dhe me përmbajtje si vijon:

A. Prezantimin e blerësit:

- i. emri, gjegjësisht firma e ofertuesit, adresa dhe numri tatimor,
- ii. të dhënat kontaktuese të personit të autorizuar,
- iii. prezantimi – përshkrimi i shkurtër i veprimtarisë së personit të interesuar, përfshirë edhe vëllimin tregtar,
- iv. identitetin e pronarit përfundimtar të personit të interesuar,
- v. deklaratën, se personi i interesuar punon në emër dhe për llogari të tij,
- vi. përshkrimi i qëllimit të blerjes së të arkëtueshmeve,

- vii. deklarata se ofertuesi i ka të gjitha lejet e brendshme dhe lejet e tjera të nevojshme për dhënie të ofertës obliguese, si dhe përmbush të gjitha kushtet për marrjen nga organet kompetente të pëlqimeve që nevojiten për vlefshmërinë e blerjes së të arkëtueshmeve,
 - viii. të dhënat themelore financiare – bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave për tri vitet e fundit, gjegjësisht për tërë kohën e veprimtarisë, nëse ajo kohë është më e shkurtër,
 - ix. deklaratën se kundër blerësit nuk është iniciuar procesi i likuidimit, falimentimit, barazimit, apo ndonjë proces tjetër insolvent i ristrukturimit.
- B. Deklaratën për rrethanat e blerjes financiare dhe mënyrën e financimit të blerjes:
- i. përshkrimi i mënyrës së financimit të blerjes,
 - ii. provën, apo shpjegimin e sigurt se personi i interesuar ka apo do të ketë mjete të mjaftueshme financiare në dispozicion, më së paku në shumën e çmimit, siç e ka cekur personi i interesuar në ofertën e vet obliguese (shembull: deklarata e bankës për mjetet e deponuara nga ana e personit të interesuar, deklarata e bankës që vërteton qëllimin e financimit etj.),
 - iii. prezantimi konkret i burimeve faktike të mjeteve për blerje (përfshirë edhe shumën e financimit nga mjetet vetjake si dhe nga kredia e fituar nga personat e tretë (bankat etj.).
- C. Deklaratën mbi borxhet eventuale (ekzistuese apo potenciale) të ofertuesit ndaj DUTB (Shoqëria për Menaxhimin e të Arkëtueshmeve të Bankave), ku personi i interesuar përshkruan nëse ka borxh ekzistues ndaj DUTB, dhe nëse mund të ketë potencialisht një shumë të caktuar borxhi;
- D. Deklaratën mbi lidhjen e ofertuesit me Shoqëritë, ku ofertuesi përshkruan nëse ka lidhje me Shoqëritë në mënyrë pronësore, menaxhuese apo në mënyrë tjetër, bazuar në rregullat që rregullojnë shoqëritë ekonomike, pra a është ofertuesi në pajtim me rregullat që rregullojnë shoqëritë ekonomike, a ka lidhje me pronarët dhe anëtarët e bordit dhe të mbikëqyrjes së këtyre Shoqërive, ose nëse ka ekzistuar në të kaluarën një lidhje të tillë.
- E. Deklaratën se nuk ka asnjë pengesë ligjore për lidhjen e kontratës mbi shitjen e të arkëtueshmeve, sipas nenit 13 të Ligjit mbi Masat e Republikës së Sllovenisë për Përforcimin e Stabilitetit të Bankave (ZUKSB; Gazeta Zyrtare e RS, nr. 105/2012, 63/2013, 23/2014 dhe 104/2015), pra që ofertuesi:
- i. si person që në pajtim me ligjin që rregullon shoqëritë ekonomike, nuk vlerësohet i lidhur me Shoqëritë;
 - ii. nuk është person juridik, ku personi nga alineja e mësipërme (i) ka aksione, gjegjësisht anëtar i bordit apo prokurist, që ka qenë anëtar i bordit apo prokurist i ndonjërës nga Shoqëritë në afatin prej tri vjetësh para paraqitjes së arkëtueshmeve, përpos nëse është një person i lidhur me personin nga alineja e parë e këtij paragrafi në mënyrë të tillë që Republika e Sllovenisë është shoqëri mbisunduese sipas ligjit që rregullon pranimin;
 - iii. nuk është person fizik që ka qenë anëtar i bordit apo prokurist i ndonjërës nga Shoqëritë tri vjet para seç janë paraqitur të arkëtueshmet;
 - iv. nuk është person fizik që me personin fizik nga alineja e sipërme (iii) është në raport të lidhjes së ngushtë, siç e përcakton ligji që rregullon proceset për shkak të insolvencës.

- v. nuk është person, për të cilin, sipas ligjit që rregullon pranimet, dyshohet se me persona nga dy alinetë e mësipërme vepron në mënyrë të harmonizuar, përpos nëse bëhet fjalë për një person që është i lidhur me personin nga dy alinetë e mësipërme të këtij paragrafi në mënyrë të tillë që Republika e Sllovenisë paraqet shoqërinë mbisunduese sipas ligjit që rregullon pranimet;
- vi. nuk është person juridik që ka kryer kontrollin e kualitetit të mjeteve të bankës dhe testet ngarkuese të bankave në vitin 2013 (të dhënat nga personat e tillë juridikë mund t'i sigurojë DUBT);
- vii. nuk është person juridik i lidhur me kapital me personin juridik që ka kryer kontrollin e kualitetit të mjeteve të bankave dhe testet ngarkuese në vitin 2013;
- viii. nuk është person juridik, të cilin e këshillon në aspektin afarist personi juridik, që ka kryer kontrollin e kualitetit të mjeteve të bankave dhe testet ngarkuese në vitin 2013, apo që i këshillon në aspektin afarist personi fizik që si i punësuar te personat juridikë apo si nënkontraktues i atyre ndërmarrjeve, ka marrë pjesë në kontrollin e kualitetit të mjeteve të bankave dhe testeve ngarkuese të bankave në vitin 2013.
- ix. mostrat e shumicës së deklaratave, fillimisht të përcaktuara në aspektin përmbajtësor nga DUBT, janë në dispozicion në faqen e internetit të DUBT: (<http://www.dutb.eu/si/terjatve.aspx>); Format (Procesi i njohjes së palës – KYC).

F. Çmimin për blerjen e të arkëtueshmeve, afatin e pagesës dhe mënyrën e pagesës

Ofertuesi duhet ta definojë saktësisht çmimin për blerjen e të arkëtueshmeve të Blerësit ndaj Shoqërive (për shembull: Çmimi për blerjen e të arkëtueshmeve të Shitësit ndaj Shoqërive bashkë me shtojcat dhe të drejtat anësore është [●] EUR (me fjalë: [●]00/100 euro).

Ofertuesi duhet të përcaktojë afatin e pagesës, në ditë, duke filluar nga dita e lidhjes së kontratës për shitjen e të arkëtueshmeve. Në rast se dita e fundit e pagesës përputhet me ditën që sipas ligjit nuk është ditë pune, dita e fundit e afatit konsiderohet dita tjetër e punës.

Oferta obliguese, bashkë me deklaratat obliguese mbi mjetet në dispozicion, duhet të jetë e plotfuqishme, më së paku deri më 13.6.2022.

Nëse ofertuesi është person i jashtëm juridik, ai duhet të bashkëngjitë certifikatën nga regjistri përkatës, në të cilin është regjistruar si person juridik (përkthim i verifikuar), dhe në këtë rast certifikata nga regjistri përkatës nuk mund të jetë më e vjetër se 30 ditë.

Oferta duhet të jetë në gjuhën sllovene apo angleze. Secili ofertues mund të japë vetëm një ofertë. Në rast se ofertuesi ofron më shumë se një ofertë, të gjitha ofertat e tij do të përjashtohen.

G. Sigurimin

Shitësi do t'i marrë parasysh ofertat obliguese të ofertuesve, të cilët maksimumi deri në 13.4.2022 do të paguajnë në llogari të Shitësit, pranë UniCredit Bank sh.a, numër SI56 2900 0005 1319 162, SWIFT: BACXSI22, me thirrje në numër 00 983, sigurimin prej 50 000,00 EUR dhe që bashkë me ofertën obliguese do të japin vërtetimin mbi pagesën e sigurimit.

Pagesën e sigurimit mund ta kryejë në mënyrë të vlefshme vetëm ofertuesi me pagesën e mjeteve nga llogaria bankare e hapur në Slloveni, apo nga llogaria e tij bankare e hapur në ndonjë bankë me seli në BE (duke përjashtuar Qipron, Rumaninë, Bullgarinë dhe Luksemburgun).

Sigurimi do t'u kthehet (pa interes) ofertuesve, ofertat e të cilëve do të vlerësohen nga DUTB si të papërshtatshme, pra të cilat nuk do të zgjidhen nga ana e DUTB-së.

2.2. Kontrolli i kujdesshëm

Ofertuesit do të kenë mundësi të kontrollit të kujdesshëm të dokumentacionit lidhur me të arkëtueshmet që janë objekt i shitjes (në vijim: Dokumentacioni). Kontrolli i kujdesshëm mund të kryhet çdo ditë punë gjatë periudhës 14.3.2022 deri më 13.4.2022, brenda orës 14:00. Kontrolli i kujdesshëm kryhet në mënyrë elektronike 24 orë në ditë. Gjatë kësaj kohe ofertuesit do të mund të parashtrorjnë pyetje me shkrim. Përgjigjet me shkrim të pyetjeve të cilitdo parashtrues, pjesëmarrës në proces në këtë pikë, duhet t'u dërgohen të gjithë pjesëmarrësve të tjerë. Kusht për kryerjen e kontrollit të kujdesshëm është nënshkrimi i Marrëveshjes mbi moszbulimin e informatave që do t'ua dërgojë Shitësi të gjithë ofertuesve të tjerë, në kërkesën e tyre me shkrim.

Shitësi ruan të drejtën që t'u refuzojë ofertuesve individualë, pa paraqitur arsye, shikimin e Dokumentacionit, apo t'u mundësojë shikimin e informatave të caktuara. Gjatë kontrollit të kujdesshëm ofertuesit do të kenë mundësinë e shikimit të versionit punues të kontratës mbi shitjen e të arkëtueshmeve si dhe të dhënies së komenteve në kontratë. Kontrata mbi shitjen do të lidhet në formën e shënimit noterial të zbatimit të drejtpërdrejtë, apo në një formë tjetër, nëse diçka e tillë përcaktohet në ligj apo nëse kërkohet nga shitësi sipas vlerësimit të tij.

3. Hapja e ofertave obliguese

Hapja e ofertave obliguese do të jetë publike. Shitësi do të marrë vendim mbi ofertat obliguese të pranuar në kohën e duhur, më së largu 4 (katër) javë pas skadimit të afatit për dorëzim, por nuk është i detyruar të japë asnjë shpjegim.

Shitësi e ruan të drejtën që t'i thërrasë ofertuesit për të përmirësuar apo plotësuar ofertat, apo të vazhdojë me negociata individuale me të gjithë ofertuesit e caktuar. Thirrja eventuale e DUTB-së për ofertuesit për ta rritur ofertën në kuadër të procesit nuk është refuzim i ofertave të tyre sipas paragrafit të dytë të nenit 29 OZ, kështu që mbeten në fuqi deri në fund të procesit, gjegjësisht deri te përmirësimi i ofertës nga ofertuesit e caktuar, me ç'rast ofertuesi pajtohet plotësisht.

Shitësi e ruan të drejtën që në proces të mos zgjedhë asnjërin nga ofertuesit, gjegjësisht t'i refuzojë të gjitha ofertat e propozuara. Gjithashtu, nuk është i detyruar të lidhë çfarëdo marrëveshjeje apo kontrate me asnjë ofertues lidhur me bashkëpunimin e tyre në procesin e shitjes së të arkëtueshmeve.

4. Lidhja e kontratës

Shitësi do të zgjedhë ofertuesin që do të japë ofertën më të përshtatshme, por nuk është i obliguar ta bëjë diçka të tillë, (në vijim: Ofertuesi i zgjedhur) dhe me të do të nënshkruajë ofertën mbi shitjen dhe dorëzimin e të arkëtueshmeve.

Ofertuesi do të zgjidhet në pajtim me kriteret që vijojnë: çmimi më i lartë përfundimtar i ofruar për blerjen e të arkëtueshmeve të Shitësit ndaj Shoqërive, mënyra e pagesës si dhe kërkesat e mundshme rreth përmbajtjes së kontratës mbi shitjen e të arkëtueshmeve. Shitësi do të bëjë vlerësimin e përshtatshmërisë së ofertës sipas gjykimit të tij. Në rast se më shumë një ofertues kanë dhënë çmim të njëjtë, me ofertuesit do të zhvillohen negociata individuale sipas kriterit të njëjtë për zgjedhjen e ofertës.

Ofertuesit të zgjedhur i llogaritet sigurimi në çmimin e blerjes dhe pas lidhjes së kontratës mbi shitjen e të arkëtueshmeve ka karakterin e paradhënies. Në kontratë do të merren parasysh edhe dispozitat ligjore rreth pëlqimeve eventuale të organeve kompetente, të cilat nevojiten për vlefshmërinë e kontratës.

Ofertuesi i zgjedhur do të duhet të parashtrojë më vonë edhe të dhënat shtesë në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Ofertuesi i zgjedhur do të duhet të japë edhe të dhënat mbi llogarinë bankare, nga e cila do të bëhet pagesa e blerjes (nëse llogaria bankare nuk është e hapur pranë një banke me seli në BE, kjo përbën objekt të vendimmarrjes shtesë të Këshillit të Shitësit mbi miratimin e shitjes së të arkëtueshmeve).

Shitësi dhe ofertuesi i zgjedhur prej tij do të lidhin kontratën më së largu brenda 15 ditësh pas lajmërimit mbi zgjedhjen e ofertuesit. Nëse ofertuesi i zgjedhur nga ana e Shitësit nuk e lidh kontratën, humb sigurimin në dobi të Shitësit (sigurimi nuk i kthehet ofertuesit). Në atë rast Shitësi ka të drejtë (por jo obligim) ta lidhë kontratën me ofertuesin që ka dhënë ofertën tjetër më të përshtatshme obliguese, pa e përsëritur mbledhjen e ofertave për blerjen e të arkëtueshmeve.

Ofertuesve, ofertat e të cilave Shitësi nuk i vlerëson si të përshtatshme, pra që nuk do të jenë të zgjedhura nga ana e Shitësit, do t'u kthehet sigurimi i paguar, pa interes, ditën e tretë pas skadimit të afatit për nënshkrimin e kontratës mbi shitjen e të arkëtueshmeve, me kusht që ofruesi ta parashtrojë deklaratën me shkrim, duke cekur llogarinë e ofertuesit në të cilën duhet kthyer sigurimi. Nëse ofertuesi nuk e parashtron deklaratën, sigurimi do të kthehet pa interes ditën e shtatë pas skadimit të afatit për nënshkrimin e kontratës mbi shitjen e të arkëtueshmeve, në llogarinë prej së cilës është bërë pagesa. Për rastet e përmendura në këtë paragraf, sigurimi nuk ka karakter të paradhënies dhe ofertuesi që nuk është i zgjedhur nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së dyfishtë, gjegjësisht kthimin e dëmit eventuale për shkak se nuk është i zgjedhur.

Transferimi i të arkëtueshmeve do të bëhet në pajtim me kontratën pas pagesës së shumës së plotë të blerjes. Pagesa në kohën e duhur do të jetë komponent thelbësor i Kontratës. Të gjitha tatimet dhe shpenzimet, përfshirë edhe shpenzimet eventuale të noterit në lidhje me transferimin e të arkëtueshmeve do të paguhën nga blerësi. Të arkëtueshmet shiten sipas parimit “e parë – e shitur”, dhe në këtë rast të gjitha të arkëtueshmet e Shitësit, përfshirë edhe shtesat dhe të drejtat anësore, transferohen te blerësi, në vëllimin më të madh të lejuar ligjor. Shitësi garanton vetëm ekzistencën e të arkëtueshmeve dhe jo të sigurimeve dhe fitimin e tyre.

Kontrata do të përfshijë edhe klauzolën “top-up” (pagesën e ndryshimit ndërmjet shumës së paguar të blerjes dhe shumës më të lartë në rastin e shitjes së mëtejshme) dhe klauzolën “Re-sale” (që e obligon blerësin të mos ua shesë të arkëtueshmet personave të lidhur për një periudhë pesëvjeçare, siç është definuar në nenin 13 të ZUKSB, e në rast të shkeljes së saj, Blerësi është i obliguar t’ia paguajë Shitësit dënimin kontraktues në shumën prej 50% të shumës së blerjes) si dhe dispozitën që Shitësi të shpallë publikisht realizimin e shitjes së të arkëtueshmeve, si dhe identitetin e Blerësit.

Nëse blerësi i të arkëtueshmeve është person i huaj juridik, për nevoja të përgatitjes së kontratës dhe para përpilimit të saj, ai duhet t’ia parashtrojë Shitësit numrin unik identifikues (numrin amë) që e përcakton Regjistri afarist i Sllovenisë (AJPES), ose nëse Blerësi është person i huaj fizik, numrin unik amë të qytetarit (NUAQ).

5. Të tjera

Ofertuesit i marrin vetë përsipër shpenzimet e pjesëmarrjes në shpalljen publike, gjegjësisht në procesin e shitjes së të arkëtueshmeve, si dhe të gjitha shpenzimet eventuale lidhur me të, pavarësisht nga sukcesi në shpalljen publike. Shitësi e ruan të drejtën për ndryshimin e procesit dhe kushteve të shitjes së të arkëtueshmeve.

Shpallja publike do të zhvillohet në gjuhën slovene. Shitësi mund t'i publikojë, gjegjësisht t'i parashtrojë disa dokumente edhe në gjuhë tjetër (për shembull në gjuhën angleze).

Ofertuesi që hyn në procesin e shpalljes publike pajtohet me kushtet e realizimit të saj.

6. E drejta e revokimit dhe përjashtimit të përgjegjësisë së dëmshpërblimit nga Shitësi

Shitësi ruan të drejtën që kurdo dhe pa shpjegim të ndryshojë rrjedhën e planifikuar, hapat apo elementet tjera të procesit, si dhe mund të ndërpresë procesin e mbledhjes së ofertave, të shitjes, gjegjësisht të negociatave, dhe në këto raste nuk mban asnjë përgjegjësi, ndërsa ofertuesit nuk mund t'i parashtrojnë shitësit asnjë kërkesë kundër këtyre veprimeve. Përgjegjësia e shitësit për dëmshpërblim është e përjashtuar plotësisht.

Shitësi ruan të drejtën që të mos lidhë kontratë me asnjë ofertues.

7. Informatat shtesë

Informatat themelore me qasje publike mbi Shoqërinë janë në dispozicion në www.dutb.eu. Ofertuesit potencialë mund të marrin informata shtesë te përfaqësuesja e Shitësit: Nina Pitamic, nr. tel.: +386 1 42 93 884, e-mail: nina.pitamic@dutb.eu.

8. Të drejtat dhe kompetencat

Për këtë konkurs apo shpallje publike, për proceset lidhur me këtë shpallje, për mbledhjen e ofertave dhe për kontratën mbi shitjen e të arkëtueshmeve zbatohet ligji i Republikës së Sllovenisë. Në rast të çfarëdo mosmarrëveshjes, kompetencat në aspektin vendor dhe përmbajtjesor i ka gjykata e Lubjanës.

Kjo shpallje është publikuar në gjuhën slovene.

Shoqëria për Menaxhimin e të Arkëtueshmeve të Bankave, sh.a.